



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT 11 OCT 2024
14-020/04-133896/24, më

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/04 qershor 2008), nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Netyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenit 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve dhe Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, si dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në përbërjen si në vijim:
 - 1.1. Fadil Gashi, Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë, Kryesues;
 - 1.2. Agim Cukaj, Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; anëtar;
 - 1.3. Veton Demolli, Drejtorja e Inspektionit, anëtar;
 - 1.4. Merita Tolaj, Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare; dhe
 - 1.5. Afërdita Hasimi, Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, anëtare.
2. Sekretar i Komisionit caktohet Fadil Gashi i cili do të veprojë në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara sipas nenit 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
3. Përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë:
 - 3.1. Organizon numrin e nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vetë komisioni lokal;
 - 3.2. Cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve;
 - 3.3. Kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje

- 3.4. Bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe ju ofron ndihmën e nevojshme profesionale;
 - 3.5. Përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim;
 - 3.6. Raportin e miratuar nga asambleja komunale ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror;
 - 3.7. Propozon prioritetet për shfrytëzimin e mjeteve të ndara për sanimin dhe mënjanimin e pasojave
 - 3.8. Mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës.
4. Mandati i komisionit është katër (4) vjeçar.
 5. Komisioni aktual është i obliguar që t'i bart me procesverbal tek Komisioni i themeluar sipas këtij vendimi të gjitha kërkesat që i ka pranuar dhe janë në shqyrtim.
 6. Me nxjerrjen e këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. 14-020/04-67857/23 i datës 30.03.2023 si dhe 14-020/04-140828/23 te datës 07.07.2023.
 7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

